

VENDIM
Nr.991, datë 2.7.2008

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.48, DATË 16.1.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MASËN DHE KRITERET E PËRFITIMIT NGA PROGRAMI I
NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË, NË VËSHTIRËSI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 8 të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995 “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr.48, datë 16.1.2008 të Këshillit të Ministrave, fjalët “...duke filluar nga muaji i nëntë...” zëvendësohen me “...në muajin e pestë a të gjashtë dhe në muajin e njëmbëdhjetë e të dymbëdhjetë të kontratës...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha